

URDHËR
Nr. 618, datë 16.10.2025

**PËR AUTORIZIMIN DHE DELEGIMIN E DISA KOMPETENCAVE/AUTORITETIT
TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, ZËVENDËSMINISTRIT TË DREJTËSISË, z. TEDI
DOBI**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Z. Tedi Dobi, gjatë ushtrimit të funksionit si zëvendësministër i Drejtësisë, zbaton dhe mban përgjegjësi për detyrat që i caktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

2. Zëvendësministri i Drejtësisë përgjigjet para ministrit të Drejtësisë për mbarëvajtjen e punëve lidhur me procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, zbatimin efektiv të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, zbatimin efektiv të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, si dhe hartimin e monitorimin e Agjendës së Reformave në kuadër të Planit të Rritjes.

3. Zëvendësministri i Drejtësisë monitoron dhe koordinon punën për miratimin, zbatimin dhe nëse është e nevojshme përditësimin/ndryshimin e strategjive ndërsektoriale në fushën e drejtësisë, Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, si dhe mbikëqyr procesin e raportimeve përkatëse, në kuadër të zbatimit të këtyre dokumenteve në bashkëpunim me institucionet e drejtësisë dhe partnerët ndërkombëtarë.

4. Në kuadër të realizimit të raporteve për strukturat e Bashkimit Evropian, zëvendësministri i Drejtësisë drejton procesin e hartimit të Raportit për Sundimin e Ligjit dhe e validon atë para dërgimit pranë strukturave të Bashkimit Evropian.

5. Zëvendësministri i Drejtësisë monitoron masat dhe koordinon raportimet e Ministrisë së Drejtësisë, në kuadër të procesit të integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, në bashkëpunim me strukturat përkatëse/kompetente të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme dhe integrimin në Bashkimin Evropian.

6. Kostot financiare për ushtrimin e kompetencave të parashikuara në urdhër nga zëvendësministri i Drejtësisë përballohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Ushtrimi i kompetencave të deleguara sipas këtij urdhri, fillon nga data e hyrjes në fuqi e tij dhe përfundon me:

a) shfuqizimin e këtij urdhri; ose

b) përfundimin e ushtrimit të funksioneve të zëvendësministrit të Drejtësisë nga z. Tedi Dobi.

8. Urdhri nr. 229 datë 26.4.2024, i ministrit të Drejtësisë, “Për përcaktimin e detyrave të zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Tedi Dobi”, shfuqizohet.

9. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Tedi Dobi, për zbatimin këtij urdhri.

10. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Besfort Lamallari